



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

DOKUMENTI I RREGULLORES

PËR MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR “NDËRTIMIN E
HIDROCENTRALEVE SETA 1+2, SETA 3 DHE SETA 4”, MBI PËRROIN E SETËS,
ME SHTRIRJE NË TERRITORIN E QARKUT DIBËR

MIRATOHET
KRYETARI I K.K.T.

Z. EDIRAMA



ZËVENDËS KRYETARE E KKT

Znj. EGLANTINA GJERMENI

Ministër i Zhvillimit Urban



Z. DAMIAN GJIKNURI

Ministër i Energjisë dhe Industrisë



Miratuar me Vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit Nr.10, Datë 09.09.2015

Projektues: J.E.B.S. sh.p.k



TABELA E PËRMBAJTJES SË DOKUMENTIT TË RREGULLORES

1. Dispozita të Përgjithshme
 - 1.1 Baza Ligjore
 - 1.2 Përshkrim i zonës së studiuar
 - 1.3 Përkufizimi i termave të përdorur
2. Ekstrakte të Instrumentit të Përgjithshëm Vendor (nëse zona ku parashikohet zhvillimi ka një IPV të miratuar në KKT)
 - 2.1 Orientimet dhe Detyrimet që rrjedhin nga IPV
 - 2.2 Rregullat, normat dhe standartet e zhvillimit
 - 2.3 Seti i fragmenteve të hartave të IPV për zonën në zhvillim
3. Analiza e Gjendjes Ekzistuese (elementët ekzistues të territorit)
 - 3.1 Informacion për topografinë e zonës.
 - 3.2 Informacion për burimet natyrore dhe mjediset pyjore (nëse IPV ka parashikuar zona të tilla)
 - 3.3 Informacion mbi zona të mbrojtura natyrore dhe ato të trashëgimisë kulturore dhe historike
 - 3.4 Informacion mbi infrastrukturën ekzistuese të zonës për zhvillim dhe zonave përreth saj
 - 3.5 Përmbledhje dhe gjetjet kryesore të Analizës të Gjendjes Ekzistuese
4. Rregullat e Zhvillimit të Territorit
 - 4.1 Funkcionet dhe aktivitetet e propozuara të strukturave dhe/ose parcelave
 - 4.2 Hapësira e zënë me ndërtesa
 - 4.3 Pamja e Jashtme e Godinave / Trajtimi i Fasadave / Trajtimi i Mbulesave
 - 4.4 Përcaktimin e treguesve për zhvillim për secilën parcelë
 - 4.5 Rregullat e zhvillimit
 - 4.6 Vendqëndrimi për automjetet
5. Rregullat e Rrjeteve të Infrastrukturës
 - 5.1 Pozicionimin e shërbimeve dhe rrjeteve kryesore të infrastrukturave
 - 5.1.1 Rrjeti Rrugor
 - 5.1.2 Rrjeti i furnizimit me energji elektrike
 - 5.1.3 Impianti i mbrojtjes kundra zjarrit
 - 5.1.4 Impianti i shkarkimit të ujrave të zeza
 - 5.1.5 Impianti i furnizimit me ujë
 - 5.1.6 Impianti i shkarkimit të ujrave të shiut
 - 5.2 Hapësirat e lira dhe të gjelbërta
6. Fazat e Zhvillimit të Lejes së Ndertimit
7. Relacionin e manaxhimit të inerteve të dala si rezultat i punimeve që do të kryhen për realizimin e projektit.

8. Vlerësimi i Ndikimeve Kryesore në Mjedis

- 8.1 Ndikimi mbi sipërfaqen e tokës
- 8.2 Ndikimi mbi ujërat sipërfaqësore
- 8.3 Ndikimi mbi ujërat nëntokësore
- 8.4 Ndikimi mbi Biodiversitetin (Flora, Fauna, Habitatet, Pyjet etj)
- 8.5 Ndikimi mbi manaxhimin e tokës dhe mbetjeve
- 8.6 Ndikimi mbi peizazhin
- 8.7 Ndikimi mbi zhurmat dhe ajrin
- 8.8 Ndikimi mbi trashëgiminë kulturore dhe arkeologjinë

9. Anekse (Hartat në format A3)

Për HEC Seta 1+2:

- 9.1. Planvendosja e nënobjekteve (ortofoto) dhe Vend grumbullimet i materialeve;
- 9.2 Planimetria dhe prerja tërthore e veprave të marrjes;
- 9.3 Planimetria e godinës së centralit dhe basenit të presionit;

Për HEC Seta 3:

- 9.4 Planvendosja e nënobjekteve (ortofoto);
- 9.5 Planimetria godinës së centralit, veprave të marrjes dhe basenit të presionit;

Për HEC Seta 4:

- 9.6 Planvendosja e nënobjekteve (ortofoto) dhe Vend grumbullimet i materialeve;
- 9.7 Planimetria godinës së centralit, veprave të marrjes dhe basenit të presionit;



1. Dispozita të Përgjithshme

1.1 Baza Ligjore

Shoqëria "HYDRO SETA" sh.p.k ka shprehur interesin e saj për të ndërtuar burime të reja hidro – energjitike në kuadrin e prioriteteve të qeverisë. Mbas lidhjes së Marrëveshjes Konkensionare Nr. 67 rep. Nr. 19 kol. datë 01.02.2013 dhe Kontratës Shtesë Nr. 308 rep. Nr. 153 kol datë 27.05.2014 të formës "BOT" me Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë në përputhje me legjislacionin në fuqi ka hartuar projektin e zbatimit për HEC-et SETA 1+2, SETA 3 dhe SETA 4 në Bashkinë Dibër, rrethi Dibër, qarku Dibër.

Në zbatim të kuadrit ligjor:

Për koncesionin

- Ligji Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar;
- Ligji Nr. 9663, datë 18.12.2006 "Për koncesionet";
- Akt normativ i KM, Nr.1, dt. Aktit: 05.05.2010 dhe Ligji Nr. 10157, datë 15.10.2009 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 9663";
- VKM Nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores të zhvillimit të territorit", i ndryshuar;
- VKM Nr. 671, datë 29.07.2015 "Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit".

Për mjedisin

- Ligji Nr. 10448, datë 14.07.2011 "Për lejet mjedisore", të ndryshuar;
- Ligji Nr. 60/2014, datë 19.06.2014 "Për disa ndryshime në Ligjin Nr. 10448, datë 14.07.2011 "Për lejet mjedisore", të ndryshuar;
- Ligji Nr. 44/2013, datë 14.02.2013 "Për disa ndryshime në ligjin Nr. 10448, datë 14.07.2011 "Për lejet mjedisore", të ndryshuar;
- Ligji Nr. 10431, datë 09.06.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit";
- Ligji Nr. 31/2013, datë 14.02.2013 "Për disa ndryshime në Ligjin Nr. 10431, datë 09.06.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit";
- Ligji Nr. 9983, datë 08.09.2008 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 8934, datë 05.09.2002 "Për mbrojtjen e mjedisit", i ndryshuar;
- Ligji Nr. 10440, datë 07.07.2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis";
- Ligji Nr. 10463, datë 22.09.2011 "Për manaxhimin e integruar të mbetjeve", të ndryshuar;
- Ligji Nr. 156/2013, datë 10.10.2013 "Për disa ndryshime në ligjin Nr. 10463, datë 22.09.2011 "Për manaxhimin e integruar të mbetjeve", të ndryshuar;
- Ligji Nr. 32/2013, datë 14.02.2013 "Për disa ndryshime në ligjin Nr. 10463, datë 22.09.2011 "Për manaxhimin e integruar të mbetjeve", të ndryshuar;
- Ligji Nr. 8906, datë 06.06.2002 "Për zonat e mbrojtura";
- Ligji Nr. 9868, datë 04.02.2008 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 8906, datë 06.06.2002 "Për zonat e mbrojtura";
- Ligji Nr.10006, datë 23.10.2008 "Për mbrojtjen e faunës së egër", të ndryshuar;
- Ligji Nr. 41/2013, datë 14.02.2013 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 10006, datë 23.10.2008 "Për mbrojtjen e faunës së egër", të ndryshuar;

- Ligji Nr. 9587, datë 20.07.2006 “Për mbrojtjen e biodiversitetit”, të ndryshuar;
- Ligji Nr. 68/2014, datë 03.07.2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 9587, datë 20.07.2006 “Për mbrojtjen e biodiversitetit”, të ndryshuar;
- Ligji Nr. 37/2013, datë 14.02.2013 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 9587, datë 20.7.2006 “Për mbrojtjen e biodiversitetit”, të ndryshuar;
- Ligji Nr.111/2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”;
- Vendim i KM Nr. 13, datë 04.01.2013 “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis”.
- Udhëzim Nr. 3, datë 02.12.2013 “Për VNM dhe Lejet e Mjedisit”;
- Udhëzim Nr. 6, datë 27.12.2006, “Për miratimin e metodologjisë së Vlerësimit paraprak të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis”.

1.2 Përshkrim i zonës së studiuar

HEC SETA 1+2, SETA 3 dhe SETA 4 janë projektuar të shfrytëzojnë ujërat e Përroit të Setës, me sipërfaqe të pellgut përkatësisht 100 km². Aksi i HEC Seta 1+2 vendoset në kuotën 780 m mbi nivelin e detit (*në vijim mnd*), aksi i HEC Seta 3 vendoset në kuotën 704 m mnd dhe aksi i HEC Seta 4 në kuotën 385.5 m mnd.

Përroi i Setës është degë e lumit Drinit të Zi dhe shtrihet në pjesën shqiptare të zonës së Dibrës. Ai kufizohet me lumin Drin në lindje, Zall-Dardhën në veri, pellgun e Përroit të Shehit në jug dhe Maja e Dushkës dhe Buza e Dejeve e në pjesën perëndimore.

Pellgu ujëmbledhës në studim ndodhet në nënzonën Mesdhetare Malore Verlindore. Në këtë nënzonë temperaturat mesatare vjetore, deri në lartësinë 1300 m mnd qëndrojnë në kufirin 7°C -15 °C, ndërsa në pjesën më të lartë prej 3°C deri 6°C; në pika të veçanta edhe më të ulta. Minimumet absolute të temperaturave lëkundën në intervalin -10 °C deri -13°C dhe në dimra të ftohtë ato zbresin deri -18°C, në raste të rralla nga -22 deri -26 °C.

1.3 Përkufizimi i termave të përdorur

<i>Kontratë koncesionare “BOT”</i>	Kontratë e formës “BOT” dhe kontrata shtesë (ndërtim-operim-transferim) për ndërtimin e hidroçentraleve “Seta 1+2”, “Seta3” dhe “Seta 4”;
<i>MEI</i>	Ministria e Energjisë dhe Industrisë;
<i>Autoritet kontraktues</i>	Do të quhet MEI;
<i>Veprat e Marrjes së Ujit</i>	Shërbejnë për marrjen e ujit nga lumi;
<i>Tubacionet e derivacionit</i>	Tubat që çojnë ujë në turbinat;
<i>Zhavorkapës</i>	Vendi ku depozitohet zhavor në fillim të kanalit;
<i>Kanali i Derivacionit</i>	Kanali që çon ujin në turbinat;
<i>Baseni i Presionit</i>	Puseta që realizon daljen e kanalit të derivacionit me tubat e derivacionit;
<i>Godina e Çentraleve</i>	Ndërtesa ku vendosen turbinat;
<i>Turbinë-Gjenerator</i>	Makina që shndërrojnë energjinë kinetike në energji elektrike;
<i>Kanalet e Shkarkimit</i>	Kanalet që përcjellin ujin mbas turbinave në lumë;
<i>m mnd</i>	Metra mbi nivelin e detit;
<i>HEC</i>	Hidroelektrocentral;

Shkëmbij Ultrabazik

Shkëmbij të masivit ultrabazik të Lurës,
të cilat mbartin rezerva të mëdha ujore;

Shkëmbij Terrigjen

Janë të formuara nga erozioni i shkëmbinjëve
sipërfaqësor ekzistues;

Depozitimi Aluvionesh

Vënde ku grumbullohet materialet që transportohen
nga lumi;

2. Ekstrakte të Instrumentit të Përgjithshëm Vendor (nëse zona ku parashikohet zhvillimi ka një IPV të miratuar në KKT)

Zona në të cilën zhvillohet projekti HEC Seta 1+2, Seta 3 dhe Seta 4 në Bashkinë Dibër, qarku Dibër, referuar dhe informacionit nga faqja web e AKPT-së (www.planifikimi.gov.al), nuk ka IPV të miratuar në KKT.

shk 1:10 000



3. Analiza e Gjendjes Ekzistuese (elementët ekzistues të territorit)

3.1 Informacion për topografinë e zonës.

Lugina e Përroit të Setës është degë e lumit Drini i zi, në të cilën është parashikuar ndërtimi i HEC Seta 1+2, Seta 3 dhe Seta 4. Kjo luginë është e pozicionuar ndërmjet Runjës së Peshkopisë dhe Runjës së Lurës. Tipari dallues i kësaj lugine është se pjesa e sipërme e saj përbën një luginë tipike në formë 'V'-je, duke u zgjatur paralel me kreshtat rrethuese. Kjo luginë zgjerohet gradualisht e përfundon në pellgun e Setës, para se të kthehet nga lindja. Ky pellg gati i rrumbullakët, ka një diametër afërsisht 3 km. Në kuotat 500-700 m mnd lugina ngushtohet në një gjatësi rreth 2500 m, këtu përfundon edhe gryka e Përroit të Thatë. Mbas kuotës 500 m mnd lugina e përroit zgjerohet deri në grykëderdhjen e vet në lumin Drin i Zi në një gjatësi rreth 4000 m.


3.2 Informacion për burimet natyrore dhe mjediset pyjore (nëse IPV ka parashikuar zona të tilla)

Nuk ka IPV për këtë zonë. Për këtë qëllim Komuna Arras na ka informuar me shkresën Nr. 32/1 prot, datë 20.01.2015 dhe Komuna Lurë me shkresën Nr. 129 prot datë 19.12.2015.

3.3 Informacion mbi zona të mbrojtura natyrore dhe ato të trashëgimisë kulturore dhe historike.

Informacion mbi zona të mbrojtura natyrore:

Zona në të cilën zhvillohet projekti HEC-et Seta 1+2 , Seta 3 dhe Seta 4 në njësitë administrative Lurë dhe Arras, rrethi Dibër, qarku Dibër, referuar dhe informacionit nga faqja web e ASHIGJ (Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor-së (www.geoportal.asig.gov.al), nuk shtrihet në zona të mbrojtura.



Zona ku zhvillohen HEC-et

Imazh i marrë nga web-i i ASHIGJ (www.geoportal.asig.gov.al)

Informacion mbi zona të trashëgimisë kulturore dhe historike:

Nga aplikimi në Ministrinë e Kulturës, me Vendimin Nr. 26 datë 05.03.2015 të Këshillit Kombëtar të Restaurimeve dhe Nr. 355 datë 17.11.2014 të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë, rezulton nuk e kanë identifikuar si zonë arkeologjike me trashëgimi kulturore apo historike, megjithatë sipas kontratës së lidhur me Ministrinë e Kulturës, investitori është i detyruar që të lajmërojë në rastet kur vihet re ndonjë objekt me vlerë arkeologjike.

[Signature]
7

3.4 Informacion mbi infrastrukturën ekzistuese të zonës për zhvillim dhe zonave përreth saj

Infrastruktura ekzistuese

Zona përshkohet nga rruga automobilistike Rrëshen - Kurbnesh - Fushë Lurë dhe Peshkopi - Komuna Arras. Ndërtimi i veprave hidroteknike të HEC-ve Seta 1+2, Seta 3 dhe Seta 4, në afërsi të kësaj rrugë lehtëson punimet ndërtimore të tij dhe kushtet e shfrytëzimit.

Përsa i takon rrjetit elektrik, nënstacioni më i afërt është ai i Fushë Cidhnes 35 kv, ku edhe është parashikuar lidhja me Rrjetin Hidroenergjitik Shqiptar.

Përsa i takon rrjetit të tensionit të mesëm ai është 6 kv nga Fushë Cidhne në Arras dhe Cidhen ndërsa nga ana tjetër nga Fushë Lura në Gurrë Lurë. Kryesisht rrjeti i tensionit të mesëm është shumë i amortizuar.

Rrugët e nevojshme për ndërtimin e HEC-ve mund të klasifikohen në dy kategori:

- rrugët e hyrjes për në vendndodhjen e ndërtesës së centralit;
- rrugët e hyrjes për tek veprat e tjera (vepra marrjes, kanali, baseni, tubacioni), të cilat do të përdoren gjatë ndërtimit.

Rruga e hyrjes për në ndërtesën e centralit është propozuar si një rrugë lidhëse nga rruga ekzistuese rajonale. Rrugët e hyrjes, që përdoren gjatë fazës së ndërtimit, janë pjesë përbërëse e punimeve civile për ndërtimin e HEC-ve dhe kosto e ndërtimit të tyre është përfshirë në kostot përfundimtare të punimeve.

3.5 Përmbledhje dhe gjetjet kryesore të Analizës të Gjendjes Ekzistuese.

3.5.1 Statusi i zonës në studim

Në fshatrat përreth, kësaj zone, historikisht dhe tradicionalisht, gjë që vazhdon edhe sot, ka gjetur zhvillim bujqësia dhe blegtoaria, por kohët e fundit një vend të rëndësishëm po merr dhe sektori i shërbimeve. Nga aktivitetet e mësipërme popullsia mbulon 70%-100% të nevojave ekonomike. Duke qenë se banorët e kësaj zone çdo ditë e më shumë po largohen, si jashtë shtetit por edhe drejt qytetit për mungesë të vendeve të punës, hapja e një aktiviteti do të zbuste sadopak emigracionin, i cili po ecën me ritme të shpejta kohët e fundit.

3.5.2 Variantet e zhvillimit në perspektive

Shtimi i kërkesave të tjera për energji elektrike, kërkon të bëhet i mundur shfrytëzimi me efijence i kapaciteteve ekzistuese, për të punuar me ngarkesë mesatare dhe në pik, për plotësimin e nevojave dhe si rrjedhim do të ketë një ndikim pozitiv duke lehtësuar shkëmbimin e energjisë. Mbështetur në investimin, që do të realizohet, do të kemi një shtim të kapaciteteve prodhuese të energjisë elektrike.

Ndërkohë, duke përfshirë në projekt ndërtimin e linjave të tensionit të lartë të transmetimit të energjisë, do të kemi dhe ulje të ndjeshme të humbjeve teknike, po kështu rajoni do të furnizohet me energji me parametra nominale.

Rrjeti transmetues është përgatitur në mënyrë të tillë që të mbulojë nevojat me një kosto minimale, humbje minimale, ndikim minimal në mjedis dhe me një shërbim cilësor e të mjaftueshëm.

Ndërtimi i HEC-ve Seta 1+2, Seta 3 dhe Seta 4 dhe kalimi direkt i prodhimit të energjisë në linjën e transmetimit të energjisë elektrike, bëhet në mënyrë të tillë që ai të

plotësojë nevojat e zonës në fjalë më një kosto minimale dhe ndikimin minimal në mjedis dhe të përmirësojë parametrat e sistemit energjistik.

3.5.3 Mendimi i komunitetit

Për zhvillimin e këtij projekti shoqëria "Hydro Seta" sh.p.k i ka kushtuar një vëmendje të veçantë bashkëpunimit me pushtetin vendor. Që në fillimin e studimeve përkatëse për këtë projekt, është marrë kontakt me drejtuesit e komunave përreth, duke i kërkuar miratimin në parim të projektit për ndërtimin e hidrocentraleve. Edhe në fazën e hartimit dhe miratimit të projektit të zbatimit është diskutuar gjerësisht me komunitetin dhe pushtetin vendor duke garantuar aprovimin e ndërtimit të hidrocentraleve me vendim të këshillit të njëjësive administrative Arras dhe Lurë.

3.5.4 Planet e zhvillimit urban të zonës

Zhvillimi i kësaj hapësire parashtron disa kërkesa dhe kushte rigoroze ndaj vendim marrësve. Projekti i ndërtimit të hidrocentraleve Seta 1+2, Seta 3 dhe Seta 4, gjithmonë duke minimizuar efektet negative në peizazhin e kësaj lugine, do të kontribuojë në furnizimin me energji elektrike të pandërprerë dhe me parametra të mirë.

4. Rregullat e Zhvillimit të Territorit

4.1 Funkcionet dhe aktivitetet e propozuara të strukturave dhe/ose parcelave

Qëllimi themelor i projektit është prodhimi i pastër i energjisë elektrike duke realizuar një vlerësim të përgjithshëm të integruar dhe në kohë të ndikimeve mjedisore të projektit me synim parandalimin dhe zbutjen e ndikimeve negative në mjedis. Duke i analizuar nënobjektet e HEC-ve kemi si më poshtë vijon:

- 1. Vepra e marrjes dhe Dekantues*
- 2. Kanal/tubacion derivacioni*
- 3. Basen Presioni*
- 4. Tubacion presioni*
- 5. Godinë centrali*
- 6. Kanal shkarkimi*
- 7. Punimet elektro-Mekanike.*
- 8. Linja e tensionit dhe n/stacioni.*

1. Veprat e marrjes

Veprat e marrjes së hidrocentraleve Seta 1+2, Seta 3 dhe Seta 4 do ndërtohet në zonën gjeologjike të Mirëditës, në fshatin Gurrë-Lurra dhe Arras. Vepra e marrjes janë të tipit "Anësor". Për HEC Seta 1+2 veprat e marrjes janë në kuotën 1138 m mnd dhe 1137 m mnd. HEC Seta 3 vepra e marrjes janë në kuotën 778 m mnd dhe HEC Seta 4 e ka veprën e marrjes 489 m mnd. Karakteristikat topografike, hidrologjike dhe gjeologjike të vendndodhjes së veprave së marrjes ndikojnë përmasat e projektimit të veprës së marrjes. Vepra e marrjes konsiston në:

Trupi i veprës - kanali shkarkimit, kanali ujit me mbledhësin e mbeturinave, kaskadë për shpërndarjen e energjisë dhe mure anësore, me dimensione si një funksion i shkarkimeve

maksimale dhe kushteve të shtratit të përroit (në anën e sipërme dhe të poshtme të rrjedhës). Në fund të kanalit do të ketë një ndërprerës të rrjedhës.

Dekantuesit do të ndërtohen në këto kuota: HEC Seta 1+2 ne kuoten 1129 m, HEC Seta 3 në kuotën 777 m, HEC Seta 4 ne kuoten 488 m. Duke patur në konsideratë topografinë e zonës dhe përmbajtjen e ujit, janë përzgjedhur përmasat e rezervuarit, që përdoret për dekantimin e copëtimeve të depozituara me diametrin e lejuar. Prurjet e tepërta do të largohen nëpërmjet kanalit shkarkimit të veprës marrjes në shtratin e lumit.




Fig: Paraqitja skematike e veprës së marrjes

A handwritten signature in blue ink, consisting of stylized cursive letters.

2. Kanali i derivacionit

Kanali i derivacionit të HEC Seta 1+2 do të ndërtohet në krahun e majtë të perroit. Kanali do të ketë një gjatësi prej rreth 4778 m nga i cili 1667 m janë tubacion diametër 400-600 mm kurse 3111 m është kanal i hapur me dimensionet 1.5 x 1.5 m. Në këtë hidrocentral gjithashtu ndodhen dy tunele perkatesisht me gjatësi 830 m dhe 113 m. HEC Seta 3 dhe HEC Seta 4 nuk kanë kanal deviacioni por kanë Tubacion presioni. Kanali dhe tunelet janë projektuar si kanal me rrjedhje të lire dhe presioni dhe do të vendosen në shkëmbinj ultrabazik dhe gëlqeror. Treguesit kryesor të vetive fiziko - mekanike të shkëmbinjve terrigjenë të zonës së ndërtimit të veprës së marrjes të hidrocentraleve Seta 1+2 do të jenë të njëjtë me ato të vetive fiziko - mekanike të formacioneve ku do ndërtohet dekantuesit. Në fillim të kanalit janë projektuar ndërprerës dhe porta për qëllime mirëmbajtjeje apo një mbyllje e tunelit të derivacionit. Pastrimi i dekantuesit do të realizohet me anë të një tubi kullimi (drenazhimi), të instaluar në pjesën më të ulët të dekantuesit.

3. Baseni me presion

Baseni me presion i hidrocentraleve do të ndërtohet në formacione ultrabazik dhe gëlqeror. Baseni i presionit i HEC Seta 1+2 ndodhet në kuotën 1129 m mnd. HEC Seta 3 e ka basenin e presionit në kuotën 777.3 m mnd dhe HEC Seta 4 e ka basenin e presionit në kuotën 488.5 m mnd.




Fig. Paraqitja skematike e Basenit të Presionit

4. Ndërtesat e centraleve.

Ndërtesat e centraleve të HEC Seta 1+2 do të ndërtohen në luginën e Përroit të Setes, në një zonë të mbushur me depozitime aluvionesh në kuotën 780 m mnd. Ndërtesa e centralit të HEC Seta 3 do të ndërtohet gjithashtu në luginën e përroit të Setës në kuotën 704 m. Ndërtesa e centralit të HEC Seta 4 do të ndërtohet në pjesën e poshtme të luginës së përroit të Setës në kuotën 385.5 m mnd. Pjesa fundore e shpateve, në nivelet e ulëta të luginës është e mbushur me depozitime proluviale e koluviale shpatore me filtrueshmëri të lartë.

Përmasat e brëndshme të ndërtesave të centraleve janë llogaritur duke marrë në konsideratë përmasat e përgjithshme të pajisjeve. Do të kenë një dhomë të veçantë brenda

ndërtesës së centralit për personelin, megjithëse centrali është projektuar për të funksionuar pa personel. Ndërtimi do të bëhet me beton të perforcuar me mure të ndërtuar me tulla solide apo me vrime.




Figura: Paraqitja skematike e Tubacionit të Turbinave

5. Tubacioni

Për ndërtimin e tubacioneve do të përdoren tuba çeliku me diametër 700 mm deri në 2000 mm. Tubacioni i turbinave të HEC Setës 1+2 fillon në kuotën 1129 m mnd dhe përfundon në kuotën 780 m mnd me një gjatësi 1109 m dhe diametër 1400 mm. Tubacioni i turbinave të HEC Seta 3 fillon në kuotën 777 m mnd dhe përfundon në kuotën 704 m mnd me një gjatësi 930 m dhe me diametër 1600 mm. Tubacioni i turbinave të HEC Seta 4 fillon në kuotën 488 m mnd me një gjatësi 5220 m dhe dy tunele përkatësisht 805 m dhe 140 m. Dimensioi i tubit në këtë hidrocentral varion nga 700 mm – 2000 mm. Ato duhet të plotësojnë kërkesat e zakonshme të një performace cilësore dhe trashësia e murit është llogaritur duke u bazuar në presionin e brendshëm. Tubacionet do të instalohen në pozicion sipërfaqësor të lirë, me mbështetje dhe blloqe ancorimi të vendosura në pozicionet e nevojshme. Për HEC Seta 3 dhe 4 tubacionet do jenë të instaluar nën tokë.




Figura.: Paraqitja skematike e Tubacionit të Turbinave

6. Kanalet e shkarkimit (e largimit) të ujit.

Rrjedhja nga turbina nëpërmjet kanalit të hapur të largimit të ujit do të rrjedhë nga ndërtesa e centralit në shtratin e lumit. Kanalet e largimit të ujit do të ndërtohen me beton të forcuar me prerje tërthore në formë drejtkëndëshi dhe rrjedhje graviteti. Në zonën e ndërtesave të centraleve, shtrati i lumit është projektuar në mënyrë të tillë që të parandalohen përmytjet e centralit dhe të mundësohet funksionimi normal i agregateve gjatë sezonit të përmytjeve (plotave të përroit).

7. Turbinat e Centralit

Tipi i hidroturbinës zgjidhet në funksion të lartësisë së rënies dhe regjimit ujqor gjatë vitit, për një shfrytëzim optimal me rendiment sa më të lartë.

Për hidrocentralin Seta 1+2, bazuar në diagramën e përcaktimit të llojit të turbinave, zgjedhja më e përshtatshme për regjimin ujqor të dhënë nga studimi hidrologjik dhe për lartësinë e rënies neto 339.85 m dhe prurjen llogaritore 2.6 m³/sek, janë planifikuar të instalohen dy turbina *Pelton* me fuqi totale 7454 kw.

Për HEC Seta 3, rënie neto 71,69 m dhe prurje llogaritore 4.5 m³/sek është planifikuar të instalohen dy turbina *Francis* me fuqi totale 2722 kw.

Për HEC Seta 4, me rënie neto 98.13 m e prurje 6 m³/sek, janë planifikuar të instalohen dy turbina *Francis* me fuqi totale 4724 kw.

8. Linja e tensionit të lartë dhe n/stacioni

Të tre HEC-et do të lidhen me rrjetin kombëtar me një linjë të tensionit të lartë deri në N/stacionin e Fushë Cidhnës. Gjithashtu do të ndërtohet edhe një n/stacion për të tre hidrocentralet.


4.2 Hapësira e zënë me ndërtesa

Godina e centralit për nga tipologjia e saj kategorizohet si objekt industrial. Nënobjektet e tjera si vepra e marrjes, baseni i presionit dhe dekantuesi janë elemente konstruktive speciale prej betonarmeje, të cilat nuk kategorizohen si ndërtesa.

Sipërfaqja e ndërtimit të godinës së centralit Seta 1+2 do të jetë 513 m², kurse sipërfaqja për gjelbërim, vendparkim të jetë në një total prej 400 m² dhe 882 m² sip funksionale. Pra, sipërfaqja e përgjithshme e sheshit ndërtimit të godinës së centralit do të jetë 1282 m².

Sipërfaqja e ndërtimit të godinës së centralit Seta 3 do të jetë 468 m², kurse sipërfaqja për gjelbërim, vendparkim të jetë në një total prej 300 m² dhe 870 m² do të jetë sip funksionale. Pra, sipërfaqja e përgjithshme e sheshit të ndërtimit të godinës së centralit do të jetë 1170 m².

Sipërfaqja e ndërtimit të godinës së centralit Seta 4 do të jetë 468 m², kurse sipërfaqja për gjelbërim, vendparkim të jetë në një total prej 350 m² dhe 820 m² do të jetë sip funksionale. Pra, sipërfaqja e përgjithshme e sheshit ndërtimit të godinës së centralit do të jetë 1170m².



4.3 Pamja e Jashtme e Godinave / Trajtimi i Fasadave / Trajtimi i Mbulesave

Pamja e jashtme apo ndryshe fasada e godinave të centraleve, HEC Seta 1+2, Seta 3 dhe Seta 4 si dhe mbulesa e çatisë do të trajtohen në harmonizimin me tipologjinë e ndërtesave të zonës, duke bërë një ndërthurje të tipologjisë së godinave si objekte industriale me ndërtimet tipike të zonës. Do të përdoren materiale vendi (si tjegulla të kuqe apo veshje guri dhe muraturë guri ose tulle për muret). Kjo për arsye edhe të ndikimit pamor, e cila nuk duhet të thyhet shumë.



Fig. Pamje e HEC Seta 1-2



Fig. Pamje e HEC Seta 3



Fig. Pamje e HEC Seta 4

4.4 Përcaktimin e treguesve për zhvillim për secilën parcelë

Sipas kontratës së nënshkruar me Ministrinë e Mjedisit treguesit për secilën parcelë, të nxjerrë në bashkëpunim me inxhinierin e pyjores janë këto:

Kodi i ng/nëngastërës	Sipërfaqja (ha) e kërkuar	Përdorimi i territorit	Forma e Qeverisjes	Funksioni kryesor	Funksioni i Veçantë	Infrastruktura
1	KO 67/b	0.42	Inproduktive	Njqv	Jo Prodhues	Ekzistuese
2	KO 68/b	0.175	trungishte	Njqv	Prodhues	Ekzistuese
3	KO 76/a	0.145	trungishte	Njqv	Prodhues	Ekzistuese
4	KO 77/b	0.168	trungishte	Njqv	Prodhues	Ekzistuese
5	KO 78/a	0.12	trungishte	Njqv	Prodhues	Ekzistuese
6	KO 79/a	0.108	trungishte	Njqv	Prodhues	Ekzistuese
7	KO 80/c	0.18	Inproduktive	Njqv	Jo Prodhues	Ekzistuese
8	KO 80/b	0.072	trungishte	Njqv	Prodhues	Ekzistuese
9	KO 80/a	0.042	trungishte	Njqv	Prodhues	Ekzistuese
10	KO 81/a	0.18	trungishte	Njqv	Prodhues	Ekzistuese
11	KO 82/a	0.246	trungishte	Njqv	Prodhues	Ekzistuese
12	KO 83/a	0.063	trungishte	Njqv	Prodhues	Ekzistuese
13	KO 10/a	0.194	shkurre	Njqv	Prodhues	Ekzistuese
14	KO 11/a	0.098	trungishte	Njqv	Prodhues	Ekzistuese
15	KO 12/a	0.143	trungishte	Njqv	Prodhues	Ekzistuese
16	KO 13/b	0.088	trungishte	Njqv	Prodhues	Ekzistuese
17	KO 14/a	0.138	trungishte	Njqv	Prodhues	Ekzistuese
18	KO 15/a	0.161	trungishte	Njqv	Prodhues	Ekzistuese
19	KO 87/a	0.18	trungishte	Njqv	Prodhues	Ekzistuese
20	KO 86/a	0.372	trungishte	Njqv	Prodhues	Ekzistuese
21	KO 86/c	0.108	inproduktive	Njqv	Jo Prodhues	Ekzistuese
22	KO 85/a	0.24	trungishte	Njqv	Prodhues	Ekzistuese
23	KO 83/a	0.6	trungishte	Njqv	Prodhues	Ekzistuese
24	KO 153/b	0.174	cungishte	Njqv	Jo Prodhues	Ekzistuese
25	KO 154/a	0.297	cungishte	Njqv	Jo Prodhues	Ekzistuese
26	KO 154/c	0.051	inproduktive	Njqv	Jo Prodhues	Ekzistuese
27	KO 13	1.33	cungishte	Njqv	Jo Prodhues	Ekzistuese
28	KO 136/a	0.12	djerr	Njqv	Jo Prodhues	Ekzistuese
29	KO 135/a	0.7	cungishte	Njqv	Jo Prodhues	Ekzistuese
30	KO 25	0.6	cungishte	Njqv	Jo Prodhues	Ekzistuese
31	KO 132/a	0.16	cungishte	Njqv	Jo Prodhues	Ekzistuese

4.5 Rregullat e zhvillimit.

E gjithë sipërfaqja e mësipërme do të kalojë në funksion të zhvillimit të aktivitetit prodhues të hidrocentraleve Seta 1+2, Seta 3 dhe Seta 4.

TREGUESIT E ZHVILLIMIT:

• Sipërfaqja e ndërtimit të Veprave të Marrjes :	3,321 m ²
• Sipërfaqja e ndërtimit të Dekantorëve:	2,112 m ²
• Sipërfaqja e ndërtimit të Baseneve të Presionit:	558 m ²
• Sipërfaqja e ndërtimit të Godinave të Centralit:	1,449 m ²
• Sipërfaqja e ndërtimit të Derivacioneve:	5,354 m ²
• Sipërfaqja e ndërtimit të Tubacioneve të Presionit:	13,142 m ²
<u>Sipërfaqja totale e ndërtimit të Nënobjekteve:</u>	<u>25,936 m²</u>

• Sipërfaqja e sheshit të ndërtimit të Veprës së Marrjes:	4,317 m ²
• Sipërfaqja e sheshit të ndërtimit të Dekantorëve:	2,745 m ²
• Sipërfaqja e sheshit të ndërtimit të Basenit të Presionit:	725 m ²
• Sipërfaqja e sheshit të ndërtimit të Godinës së Centralit:	3,622 m ²
• Sipërfaqja e sheshit të ndërtimit të Kanalit të Derivacionit:	13,135 m ²
• Sipërfaqja e sheshit të ndërtimit të Tubacionit të Presionit:	26,284 m ²
<u>Sipërfaqja totale e shesheve të ndërtimit të Nënobjekteve</u>	<u>50,828 m²</u>

4.6 Vendqëndrimi për automjetet.

Janë parashikuar 3-5 vendparkime për automjetet e punonjësve të hidrocentralit, të cilat do të shërbejnë edhe si hapësirë për automjetet e tonazhit të rëndë, që realizojnë transportin e turbinave, gjeneratorëve apo transformatorëve të fuqisë, në raste të veçanta të remonteve të tyre.

5. Rregullat e rrjeteve të infrastrukturës

5.1 Pozicionimin e shërbimeve dhe rrjeteve kryesore të infrastrukturave

5.1.1 Rrjeti Rrugor

Siç kemi theksuar tek infrastruktura ekzistuese rrjeti rrugor që të çon në zonën ku do të ndërtohen Hidrocentralet është shumë i amortizuar. Për të mundësuar ecurinë normale të fazës së ndërtimit e më vonë të asaj të shfrytëzimit në do të kordinojme punën me pushtetin lokal për të ndërhyrë në sistemin ekzistues për ta përmirësuar atë sipas këtyre akseve:

- Përmirësimi pjesor i aksit rrugor Urak-Kurbnesh-Fushë Lurë.
 - Hapje Kanalesh.
 - Çbllokim Tombinosh.
 - Mbushje dhe Sistemim i Gropave.
 - Gjatësia e ndërhyrjes 28 km
- Ndërtim pothuaj i ri i aksit Fushë Lurë –Gurrë Lurë.
 - Punime Gërmimesh për trupin e rrugës.

- Hapje Kanalesh.
- Veprat e Artit si Tombino me Ø 400-800 mm
- Sistemimi i Rrugës me Çakull (Gjërësia e rrugës 4.5-6m)
- Gjatësia e ndërhyrjes 24 km
- Rehabilitim i aksit Arras-Cidhën.
 - Hapje Kanalesh.
 - Çbllokim Tombinosh.
 - Mbushje dhe Sistemim i Gropave.
 - Gjatësia e ndërhyrjes 3 km

Përsa u takon rrugëve të aksesit për të shkuar në nënobjektet respektive, ato janë parashikuar hollësisht në projektin e zbatimit dhe pjesa më e madhe e tyre në të ardhmen do të shfrytëzohen edhe nga komuniteti pas periudhës së ndërtimit.

5.1.2 Rrjeti i furnizimit me energji elektrike.

Zona ku ndërtohen hidrocentralet HEC Seta 1+2, HEC Seta 3 dhe HEC Seta 4, në përroin e Setës është pak e banuar dhe fshatrat më të afërt janë: Gurre, Lure, Arras dhe Cidhnës. Ndërmjet HEC Seta 3 dhe HEC Seta 4 ndodhet HEC Arras ekzistues në kuotat 500-700 m në Përroin e Setës. Ky HEC është i lidhur me një linjë 6 Kv me sistemin energjetik të vendit në nënstacionin e Peshkopisë.

Në bazë të projektit të zbatimit është parashikuar që të gjithë Hidrocentralet do të lidhen me Sistemin Energjetik Shqiptar me një linjë 35 Kv në nënstacionin e Fushë Cidhnes. Eshte planifikuar që linja që do të lidh Hidrocentralet me nën Stacionin e Fushë Cidhnes të ndërtohet për parametrat 110 Kv pasi mendohet që shumë shpejt edhe ky nën stacion do të kthehet nga 35 kv në 110 kv në kuadrin e ristrukturimit të gjithë sistemit të transmetimit të energjisë në Shqipëri.

Duhet të theksojme se me vënien në punë të këtyre Hidrocentraleve do të lehtësohet në masën 70% ngarkesa e unazës Kukës Peshkopi për shkak të rritjes së prodhimit në rajonin e Peshkopisë.

Duhet të theksojmë se e gjithë zona përreth furnizohet me një rrjet 6 kv.

5.1.3 Impianti i mbrojtjes kundra zjarrit.

Shoqëria "HYDRO SETA" sh.p.k në zbatim të kuadrit ligjor:

- 1.Ligji Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar;
- 2.Ligji Nr. 8766, datë 05.04.2001 "Për mbrojtjen nga zjarri dhe për shpëtimin", së bashku me grupin e projektuesve ka kryer studimet përkatëse për mbrojtjen ndaj zjarrit në funksion të ndërtimit të HEC-eve Seta 1+2, Seta 3 dhe Seta 4. Sistemi i hidrantëve (ujësjellësi i thjeshtë për shuarjen e zjarrit) është i përshtatshëm për godinën e centralit Seta 1+2, Seta 3 dhe Seta 4, kjo për arsye të kubaturës së godinës, si dhe mundësisë që rrjeti i hidrantëve na ofron për shuarjen e zjarrit në godinë, por në rastin tonë, duhet marrë parasysh edhe fakti i vendndodhjes së godinës, për arsye të moszhvillimit të një rrjeti furnizimi me ujë në zonën ku do të ndërtohet godina, ndaj dhe zbatimi i tij paraqet vështirësi. Për këtë arsye, për mbrojtjen

ndaj zjarrit, më e përshtatshme paraqitet sistemi me fikëset e zjarrit, e miratuar dhe nga PMNZSH-ja Dibër.

5.1.4 Impianti i shkarkimit të ujrave të zeza

Ujërat e zeza të fshatrave që ndodhen kryesisht në pjesën e sipërme të proit të Setës i derdhen ato në rrëqe e lumë, gjë e cila bie ndesh me parametrat e cilësisë së ujrave të ëmbla dhe për trajtimin e ujrave me qëllim ruajtjen e tokës dhe ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore nga ndotja.

Mënyra e zgjidhjes për godinën e centralit, për ujërat e zeza, është përdorur metoda e gropës septike, kjo për 2 arsye, të largësisë së godinës nga zona e banuar dhe mungesa e një rrjeti kanalizimesh. Kjo gropë në momentin kur mbushet do të shkarkohet me anën të makinave të posaçme që disponohen nga Ujësjiellës-Kanalizime Dibër.

5.1.5 Impianti i furnizimit me ujë

Përsa i përket infrastrukturës së furnizimit me ujë të pijshëm ajo paraqitet e amortizuar, por e mirëmbajtur nga vetë banorët, ku me anë të linjave të tubove plastike kanë realizuar zgjidhjen e infrastrukturës për përdorim uji. Projekti i hidrocentralit të Seta 1+2, Seta 3 dhe Seta 4 nuk ndikon as pozitivisht as negativisht në infrastrukturën e furnizimit me ujë të zonës, pasi nuk është projekt që varet apo zhvillohet mbi bazën e infrastrukturës së furnizimit me ujë. Madje, në zonën ku do të ndërtohet godina e centralit me përjashtim të Setës 3, nuk ka rrjet të furnizimit me ujë të zhvilluar pranë saj, kjo për shkak dhe të largësisë me zonën e banuar. Problemi i furnizimit me ujë të godinës së centralit, për arsye të veprimtarisë jetësore të punonjësve gjatë periudhës së operimit të hidrocentralit, do të zgjidhet duke ndërtuar ujësjiellës të vegjël nga burimet pranë godinave. Pranë çdo godine centrali ka burime uji të pijshëm. Pasi të respektohen të gjitha procedurat ligjore për përcaktimin e cilësisë së ujit do të lidhen me këto godina me tubacion diametër 30 mm dhe gjatësi 50 -100 m me depozitat zingato 1000 litra pranë secilës godinë.

5.1.6 Impianti i shkarkimit të ujrave të shiut

Shkarkimi i ujrave të shiut do të bëhet në përrua, me anë të një sistemi tubash plastik nga çatia e godinës së centralit deri tek përroi.

5.2 Hapësirat e lira dhe të gjelbërta

Meqenëse godina e centralit, për nga tipologjia e saj kategorizohet si objekt industrial, kështu që në projektin e saj janë respektuar sipërfaqet e duhura për gjelbërim si dhe hapësira për vendparkim të makinave të punonjësve të centralit (maksimumi 3-5 vendparkime). Sipërfaqja totale e godinave të centraleve është 1449 m² ndërsa sipërfaqja funksionale si parkime dhe sipërfaqe të gjelbërta për rrethe godinave do të jetë 1050 m². Sipërfaqet e gjelbërta do të organizohen për çdo godinë duke synuar të mbillen pemë që janë karakteristike të zonës dhe në harmoni të plotë me të.

6. Fazat e Zhvillimit të Lejes se Ndertimit

6.1 Faza e ndërtimit

Referuar Grafikut të punimeve faza e ndërtimit do të zhvillohet sipas këtij skeduli:

- Në dy muajt e para do të filloj mobilizimi i kantierit i cili do të konsistoj në ngritjen e dy kantierëve, ku kantieri i do të shërbejë për ndërtimin e HEC Seta 1+2 dhe Seta 3, ndërsa Kantieri II do të shërbejë për ndërtimin e HEC Seta 4.
- Paralel me ngritjen e kantierit që në muajin e parë do të fillojë ndërtimi i rrugëve të aksesit. Më poshtë po rendisim ndërtimin dhe rindërtimin e rrugëve të aksesit që do zgjasë 3-4 muaj:
 - Rindërtimi i rrugës Fushë Lurë –Gurre Lurë gjatësia 7 km.
 - Ndërtimi i rrugës së aksesit Gurrë Lurë Vepra e marrjes 1A,1B. HEC Seta 1+2.
 - Ndërtimi i rrugës së aksesit Gurrë Lurë – Dekantori HEC Seta 1+2.
 - Ndërtimi i rrugës së aksesit Gurrë Lurë-Ndërtesa e Centralit Seta 1+2 dhe vepra e marrjes së HEC Seta 3.
 - Ndërtimi i rrugës së aksesit Vepra e marrjes –Ndërtesën e Centralit HEC Seta 3.
 - Rindërtimi i rrugës së aksesit Arras-Cidhen-Vepra e marrjes HEC Seta 4.
 - Ndërtimi i rrugës së aksesit Cidhen-Hyrja e tunelit dhe vepra e marrjes 2 Seta 4.
- Ndërtimi veprave të marrjes 1A,1B në HEC Seta 1+2, Seta 3 në pesë muajt e parë dhe ndërtimi i veprave të marrjes 1, 2, 3 të HEC Seta 4 po ashtu në pesë muajt e parë.
- Ndërtimi i kanaleve të deviacionit, tuneleve dhe tubacioni presionit:
 - Kanali deviacionit të Setës 1+2 do fillojë që muajin e tretë paralel me veprat e marrjes.
 - Në muajin e tretë do fillojë tuneli Setës 1+2 i cili do të përfundojë në 6 muaj.
 - Tubacioni i HEC Seta 3 do fillojë muajin e 8 dhe do vazhdojë 3 muaj.
 - Instalimi tubacionit në Setën 4 do fillojë muajin e 5 dhe do të vazhdojë për 12 muaj.
 - Në muajin e tretë do fillojë ndërtimi i tunelit në Setën 4 dhe do të vazhdojë 6 muaj.
- Ndërtimi i Dekantorëve:
 - Ndërtimi i dekantorit në HEC Seta 1+2 do fillojë muajin e 6 dhe do të vazhdojë 3 muaj.
 - Ndërtimi i dekantorit dhe veprës së marrjes Seta 3 do të fillojë menjëherë mbas përfundimit të atij të Setës 1+2 në muajin e 9 dhe do të vazhdojë 3 muaj.
 - Ndërtimi dekantorit 1 dhe 2 në Setën 4 do fillojë muajin e 7 dhe do të vazhdojë 4 muaj.
- Ndërtimi i Godinave të Centraleve:
 - Ndërtimi i Godinës së Centralit Seta 1+2 do të filloj muajin e 9 dhe do vazhdojë 3 muaj.
 - Ndërtimi i Godinës së Centralit të Setës 3 do të fillojë me përfundimin e Godinës së Setës 1+2 pra mbas 11 muajsh dhe do të vazhdojë 3 muaj. Përfundon muajin e 14.
 - Ndërtimi i Godinës së Setës 4 fillon muajin e 14 dhe mbaron për dy muaj.

- Punimet e montimit elektro mekanike:
 - Montimet elektro-mekanike të Centralit Seta 1+2 muajt 13-14.
 - Montimet elektro- mekanike të Centralit Seta 3, muajt 14-15.
 - Montimet elektro-mekanike të Centralit Seta 4, muajt 15-16.
- Punimet për linjën e tensionit të mesëm dhe të lartë dhe N/Stacionit.

Këto punime do të kryhen paralel me punimet civile dhe do të fillojnë në muajin e 6 dhe do të përfundojnë në muajin e 15.

- Punimet e komisionimit, kontrollit dhe vënies në punë të hidrocentraleve do të kryhen në dy muajt e fundit, muajt e 17 dhe 18.

6.2 Faza e shfrytëzimit

- Me përfundimin e komisionimit do të vijohet me fazat e kontrollit dhe vlerësimit.
- Do të vijojmë me kontrollin dhe vlerësimin e Investimit nga AKBN dhe Ministria e linjës.
- Do të vijojmë me implementimin e planit të rehabilitimit në përputhje të plotë me detyrat e lëna në Lejet Mjedisore.
- Do të vijojmë me kontrollin dhe vlerësimin e ndikimit të Mjedisit pas fazës ndërtimore dhe rehabilitimit.
- Do të merret leja e shfrytëzimit për të gjitha objektet e ndertuara.
- Do të behen të gjitha regjistrimet e nevojshme në regjistrin e pronave.

7. Relacionin e manaxhimit të dherave të dala si rezultat i punimeve që do të kryhen për realizimin e projektit.

7.1 Hartimi i planit të rehabilitimit sipas fazave të zbatimit të projektit.

Plani i vendgrumbullimit dhe rehabilitimit përfshin zonat ku do të realizohen punime depozituese dhe rehabilituese, volumin dhe llojin e punimeve. Hidrocentralet do të zhvillohen në harmoni me vlerat e natyrës. Brigjet dhe shpatet e maleve në zonë përbejnë habitate potenciale për biodiversitetin e pasur që mbartin. Ndërtimi i veprave hidroteknike kërkon realizimin e shumë punimeve dhe ndërtimin e disa veprave (prita, kanali i marrjes së ujit, shtrim tubacionesh, ndërtim godine të turbinave etj).

Vëmendje kryesore gjatë këtyre punimeve duhet të tregohet në dy aspekte

- 1) *sistemimi i dherave të krijuar nga këto punime;*
- 2) *sistemimi i brigjeve dhe shpateve për të evituar fillimin e erozionit.*

Studimi i hollësishëm e strukturave gjeologjike, qëndrueshmërisë së tyre dhe masave të propozuar nga projektuesit e këtyre hidrocentraleve janë garanci që këto probleme mjedisore do të jenë minimale.

Pra, mund të themi se nga ky aktivitet nuk pritet të ketë ndikim mjedisor të matshëm pasi:

- Nuk ka prodhim të mbetjeve të rrezikshme;
- Nuk shkakton ndotje të tokës me shkarkime të ndryshme të lëngëta, apo të ngurta;
- Nuk ka shkarkime në ajër të gazrave apo tymrave;

- Zhurmat në mjediset e punës do të jenë brenda normës sanitare të lejuar, dhe për pasojë as zhurmat në mjediset e jashtme nuk pritet të kenë ndikim në popullatën përreth;
- Nuk ka çlirim të aromave të ndryshme, etj;
- Ka vlera normale të temperaturës dhe të lageshtisë në mjediset e punës
- Janë parashikuar marrja e të gjitha masave për mbrojtjen në punë dhe masat për evitimin e rrezikut të zjarrit.

Për këtë aktivitet është e nevojshme që të ketë bashkëpunim me autoritetet vendore dhe grupet e interesit, për ruajtjen e parametrave hidroenergjitike pa prishur ekuilibrat mjedisore dhe ato të nevojave të popullatës për nevoja të ndryshme.

Pas ndërtimit të nënveprave duhet të mbahet nën mbikqyrje rehabilitimi i zonave të prekura nga punimet, i cili duhet të fillojë menjëherë mbas përfundimit të punimeve të HEC - ve.

Në vijimësi paraqiten masat rehabilituese për HEC-et SETA 1+2, SETA 3 dhe SETA 4.

7.2 Vendgrumbullimi.

Ndërtimi i HEC SETA 1+2, SETA 3 dhe SETA 4 në fazën e ndërtimit do të kërkojë të sistemohen rreth 185.000 m³ dhera, të cilat gjenerohen nga gërmimet e ndryshme do të sistemohen në sheshin e përcaktuar me autoritet përkatëse vendore.

Një pjesë e materialit të gërmuar do jetë të përdoret për rehabilitimin e shesheve të gërmuara dhe përmirësimin e traseve të ndryshme të rrugëve.

Kjo masë dherash të gërmuar do të ndahet sipas tipeve, ku në mënyrë të veçantë do trajtohet shtresa vegjetative e tokës (top soil). Materiali do të sistemohet dhe do të ngjeshet duke harmonizuar relievin e shpatit dhe terrenit të destinuar për vendgrumbullim. Faza përfundimtare ka të bëjë me mbulimin e materialit me shtresë dheu të aftë për t'u mbjellur dhe vegjetuar.

Kjo sipërfaqe do të mbillet me bimësi vendase në mënyrë që fenomeni erodues nga shirat dhe ujërat të parandalohet, po ashtu bimësia që duhet të mbillet duhet të jetë autoktone (e përcaktuar sipas relacionit të inxhinierit të pyjeve) për të mos thyer peizazhin karakteristik të zonës.

7.2.1 Vlerësimi teknik i planifikimit të vendgrumbullimit

Planifikimi i këtij vendgrumbullimi është bërë në përshtatshmëri me terrenin duke e projektuar atë në sinkron me relievin duke shfrytëzuar hapësirat boshe të tij, në hapësira jo të pyllëzuara duke mos patur ndonjë ndikim në mjediset përreth, si dhe me miratimin e drejtorisë pyjore të zonës dhe autoritetet vendore.

Gjithashtu, janë marrë parasysh edhe formacionet e materialeve, që do të gërmohen dhe që do të depozitohen në vendgrumbullim, në mënyrë që të mos shfaqin probleme në qëndrueshmërinë (stabilitetin) e tyre në vetvete, duke evituar ndonjë rrëshqitje të dherave të këtij vend-grumbullimi.

Materiali që do të depozitohet është kryesisht material shkëmbor, aluvione të çimentuara, si dhe materialet me përbërje dherash, të cilat do të depozitohen më vete dhe do

të përdoren si mbulesë e këtij vendgrumbullim në mënyrë që me kalimin e kohës vegetacioni në këto zona mund të zhvillohet.

Gjithashtu i gjithë materiali që do të depozitohet do ngjishet, dhe në qoftë se është e nevojshme do të krijohen të gjitha kanalet drenazhuese përreth vendgrumbullim në mënyrë që ujërat sipërfaqësore të mos pengohen nga rrjedhja e tyre.

Projektimi i këtij vendgrumbullim është bërë në mënyrë të tillë që të shmangen zonat e banuara, në mënyrë që të eliminohen edhe rrisqet më të vogla nga prania e këtij vendgrumbullimi.

Siç e kemi përmendur më lart siguria në stabilitet e këtij vendgrumbullimi është studiuar, duke pasur parasysh formacionin gjeologjik të materialeve, ku mbi bazën e këtyre parametrave janë përshtatur edhe pjerrësitë e skarpatave të këtij vendgrumbullimi, të cilat variojnë nga 0 në 2m trashësi depozitimi.

Gjithashtu, për të ruajtur këto depozitime nga erozioni apo shkarjet do të bëhet një ngjeshje e mirë e saj për të shmangur fundosje të këtyre shtresave të tokës. Për të zvogëluar efektin e shpëlarjeve të këtyre sipërfaqeve nga reshjet e shiut, pjerrësitë e nevojshme me kanalet e hapura do të formohen në sipërfaqet e këtij vend-grumbullimi.

Megjithëse nuk paraqitet e nevojshme, por në qoftë se do të jetë e tillë, përreth këtij vendgrumbullimi mund të ndërtohen mure mbajtëse lokale me anë të materialit shkëmbor (gurë) në mënyrë që të evitohen rrëshqitjet e dherave në vendgrumbullim.

7.2.2 Punimet e ndërtimit në vendgrumbullim

Punimet për ndërtimin e vendgrumbullim kanë të bëjnë me punime hapje dhe sistemim të sheshit për qëllimin që do të kryejnë.

Në sheshin e vendgrumbullimit nuk është e nevojshme ndërtimi i ambienteve ndihmëse. Punimet e ndërtimit do të konsistojnë në:

- *Heqjen e shtresë vegetative së tokës*
- *Ndërtimi i kanaleve për mbledhjen e ujrave të shiut*
- *Rrethimi i sipërfaqes së vendgrumbullimit me mur teli*
- *Procesi i transportit të materialeve dhe sistemimi i tyre*

Në projektin për ndërtimin e hidrocentralit SETA 1+2, SETA 3 dhe SETA 4 bëjnë pjesë struktura të ndryshme inxhinierike, për ndërtimin e të cilave kryhen punime hapje dhe gërmimi.

Hapja e trasesë për tubacionin e presionit dhe kanaleve të derivacionit janë ndër veprat, ku sasia e dheut që gjenerohet është më e konsiderueshme, për pasojë ndërtimi i sheshit për depozitim të materialeve është një domosdoshmëri.

Transporti i materialeve për në vendgrumbullim është menduar të kryhet në frekuenca të rralla për të shmangur krijimin e pirgjeve në vendin e punës. Ngarkimi i materialit do të realizohet me eskavatore, transporti i tyre do të realizohet me kamion të tonazhit të mesëm.

Depozitimi i materialeve kërkon seleksionim të thjeshtë, pasi mbetjet janë të së njëjtës kategori "materiale amëtare dherash, gurësh, aluvionesh".

7.2.3 Sistemimi i materialeve në vendgrumbullim

Shkarkimi i materialeve në vendgrumbullim do të kryhet sipas një radhe të caktuar, që do të thotë, materialet do të shkarkohen me shtresa.

Vendgrumbullim është planifikuar të mos ngjeshet, pasi nga vetë procesi i mbushjes së tij; mbushje "me shtresa" përftohet ngjeshja natyrore dhe mekanike të lehtë.

Sipas profileve anësore në projektin për vendgrumbullimin janë të planifikuara me shtresa, trashësia e të cilave është mesatarisht 1.51 m për të gjithë sipërfaqen e planifikuar dhe pjerrësia e skarpatës varion. (30 – 35°).

Me zbatimin e metodës së ngjeshjeve nuk është e nevojshme ndërtimi i mureve mbajtëse, për arsye dhe të lartësisë së vogël që do të krijohet nga grumbullimi i dherave, megjithatë në rast se do të shihet e nevojshme do të ndërtohen mure mbajtëse të tipit gravitet me materiale vendi, të nxjerra nga gërmimet.

7.2.4 Mbyllja e vendgrumbullimit

Mbyllja e vendgrumbullimit do të bëhet në dy rrethana:

1. Kur është arritur kapaciteti maksimal i grumbullimit
2. Kur nuk gjenerohen materiale nga proceset e ndërtimit të strukturave të HEC SETA 1+2, SETA 3 dhe SETA 4 dhe në këtë pikë fillon marrja e materialit nga vendgrumbullimi për të mbuluar terrenet e prekura në masën e nevojshme.

Rasti i dytë është marrë në konsideratë të ndodhë, kështu që mbyllja e vendgrumbullimit do të kryhet kur është arritur hapja e nënobjekteve të nevojshme të HEC SETA 1+2, SETA 3 dhe SETA 4 dhe finalizimi i nënobjekteve funksionale të HEC SETA 1+2, SETA 3 dhe SETA 4. Më pas, fillon marrja e materialit nga vendgrumbullimi për të mbuluar terrenet e prekura në masën e nevojshme.

7.3 Planet për sistemimin dhe manaxhimin e materialeve që gjenerohen për shkak të aktivitetit

7.3.1 Masat për rigjenerimin e sipërfaqes së prekur nga realizimi i punimeve

- Sistemimin e materialit të mbulesës dhe të sterileve që dalin gjatë ndërtimit.
- Sistemimi i skarpave para dhe pas ndërtimit.
- Depozitimi i dheut (shtresës vegetative).
- Punimet e maturimit të shtratit të dheut.
- Mbjelljen e sipërfaqeve të reja me fidane (bimë autoktone).
- Mirëmbajtja e sipërfaqeve të mbjella.

7.3.2 Sistemimi i materiali të mbulesës dhe sterileve

Si pasojë e aktivitetit ndërtimor, që do të zhvillohet për ndërtimin e HEC SETA 1+2, SETA 3 dhe SETA 4, paraqitet e nevojshme sistemimi i materialit të gërmuar, i cili më pas do të përdoret për sistemimin e terreneve të prekura nga gërmimet.

Subjekti do të sistemoje pjesë të gërmuara nga shkëmbinjtë, me përmasa të ndryshme në vendgrumbullimin e materialeve.

Një pjesë e këtyre materialeve mund, dhe duhet të përdoren në shtratin përrenjve me qëllim shtratimin strukturor të përroit, çka do të përmirësonte cilësinë e ujit, duke frenuar erozionin e shpateve të përroit për shkak të mungesës së bimësisë në zona të caktuara. Po ashtu, me këto gurë do të krijohen strukturat mbrojtëse dhe muret e tipit gabion, çka ulin dukshëm lëvizjen e madhe të materialeve, nga vendi ku nxirren.

Ky material do të depozitohet i ndarë në dy grupe: grupi i parë do të jenë materialet jo të afta për mbjellje dhe grupi i dytë do të jetë materiali i shtresës vegetative së tokës, i cili ka aftësi vegetative dhe do të përdoret për fazën e rehabilitimit të sipërfaqeve.

Një pjesë e materialeve të ngurta (shkëmbinj të madhësive të ndryshme) merret e do të depozitohet në anë të shtratit të veprës për të realizuar krijimin e shtresave vegetale e mbjelljen e pemëve për mbrojtjen nga erozioni i mëtejshëm.

7.3.3 Sistemimi i skarpateve para dhe pas ndërtimit

Subjekti ka për detyrë e do të realizojë sistemimin e mirëmbajtjen e skarpateve. Ato do të mbahen nën vëzhgim gjatë gjithë kohës së shfrytëzimit të hidrocentralit e më pas deri në riaftësimin e terrenit. Skarpatat do të mbushen me material steril, do të përforcohen me trungje dhe do të hidhen dhera të mbulesës (me aftësi vegetative) mbi to. Mbasi të jetë lidhur toka do të fillojë mbjellja e pemëve.

7.3.4 Depozitimi i dherave të shtresës vegetative të tokës

Dheu i grumbulluar gjatë hapjes së shesheve të ndërtimit do të sistemohet në ato pjesë të sheshit, që nuk krijojnë probleme gjatë ndërtimit të nënobjekteve të HEC SETA 1+2, SETA 3 dhe SETA 4, dhe në rastin konkret shtresa vegetative e tokës (me aftësi vegetative) do të hiqet në të gjithë gjatësinë e tij. Kjo masë dheu do të ruhet për t'u përdorur në rehabilitimin e terreneve dhe përmirësim të ndikimit pamor. Rehabilitimi i shpateve të formuara nga gërmimet ndihmon edhe derivacionin në jetëgjatësinë e tij. Këto sipërfaqe, të cilat do të risistemohen, do të mbillen me bimësi vendase, të cilat rrisin qëndrueshmërinë e shpateve, çka në përfundim të tij nuk do të ketë ndikim në anën pamore të zonës.

7.3.5 Punimet e maturimit të shtratit të dheut

Para se të realizohet procesi i mbjelljes së terrenit të krijuar me bimësi vendase duhet që dheu i hedhur të maturohet në mënyrë që të ofrojë kushte të përshtatshme për mbjelljen e fidaneve. Fidanët duhet të mbillen në prani të specialistit pyjor dhe atij të Agjencisë Rajonale Mjedisore (ARM) në mënyrë që të respektohen distancat dhe varietetet e fidanëve që do të mbillen, siç janë ato vendase të përcaktuara nga inxhinieri i pyjores së shërbimit pyjor Peshkopi dhe autoritetet lokale të Peshkopisë.

7.3.6 Mbjellja e sipërfaqeve të reja me fidane

Procesi për sistemimin e terreneve të prekura nga investimi si dhe riaftësimin e territorit me gjelbërim, nëpërmjet mbjelljes së pemëve apo barit do të fillojë mbas përfundimit të punimeve (e përcaktuar sipas akt marrëveshjes me drejtorinë pyjore përkatëse), duke bërë mbjellje fidanesh të herë-pas-hershme.

Ky proces do të bëhet në një periudhë, e cila rezulton me krijimin e kushteve të përshtatshme për mbjelljen e fidanëve. Kjo periudhë përkon me periudhën e vjeshtës, mbasi të ketë përfunduar lëvizja e dherave nga gërmimet, mbyllja e fazës ndërtimore për objektin dhe risistemimi i dherave përfundimtare, duke krijuar mundësinë e mbjelljes së fidanëve përpara periudhës së shirave të parë.

7.3.7 Mirëmbajtja e sipërfaqeve të mbjella

Ajo do të realizohet nga subjekti. Mund të ngrihen prita, për të përforcuar mbrojtjen e pyjeve nga erozioni. Gjithashtu, do të kujdeset për mbarështimin e pemëve, që do të mbillen nga shoqëria. Për kullimin e ujrave që do të grumbullohen në sheshin e depozitimit të dherave do të hapen kanale për drenimin e ujrave jashtë sheshit të depozitimit.

8. Vlerësimi i Ndikimeve Kryesore në Mjedis

8.1 Ndikimi mbi sipërfaqen e tokës

Ndërtimi i veprave hidroteknike të HEC SETA 1+2, SETA 3 dhe SETA 4 nuk krijon shqetësim për komunitetin përreth, si gjatë fazës së ndërtimit ashtu dhe në fazën e shfrytëzimit. Punimet e ndërtimit do të vazhdojnë për një periudhë të vogël prej 18 muaj dhe gjatë kësaj periudhe impakti në dëmtimin e tokës do të jetë minimat ashtu siç parashikohet në VNM respektive.

Kanali derivacionit në HEC Seta 1+2 do të bëhet me përmasat 1.5x1.5 duke minimizuar dëmtimet në tokë dhe duke sistemuar dherat në vendet e caktuara. Për sa i përket kanaleve të derivacionit, ato nuk japin ndonjë ndryshim në peisazh, për arsye se ato janë punime plotësisht nëntokë në HEC-et SETA 3 dhe SETA 4 dhe nuk duken në sipërfaqe. Por duhet të theksojmë që përmasat e këtyre kanaleve (tubacioneve) janë të vegjël me një gjerësi 2 m dhe thellësi rreth 1.6 m, të cilët nuk duken nga larg dhe nga zonat e banuara, por vetëm nga kalimtarët që kalojnë aty afër. Për të evituar dëmtimet e peisazhit dhe për të shmangur zonat e thepisura dhe të aksidentuara do të ndërtohen 4 tunele me një gjatësi të përgjithshme rreth 2000 m.

Për sa i përket ndërtimit të ndërtesës së hidrocentraleve SETA 1+2, SETA 3 dhe SETA 4, vepra nuk do të vendoset mbi tokë buke, por mbi tarracën e vjetër të përroit (në anë të majtë të rrjedhjes) në një disnivel nga shtrati i sotëm ekzistues, i cili nuk do të krijojë asnjë problem në rast rreshjesh për këtë ndërtesë referuar studimit hirologjik të pellgut .

Duhet të theksojmë edhe njëherë se i gjithë kompleksi i ndërtimit të hidrocentraleve SETA 1+2, SETA 3 dhe SETA 4 duke filluar nga veprat e marrjes, kanalet e sjelljes, dekantuesi, dhe ndërtesa hidrocentralit nuk vendosen në tokë buke, por vetëm në shpate mali dhe shtratin e përroit.

Terreni është element që pëson ndryshime gjatë zbatimit të projektit, sepse:

- Do të gërmohet, lëvizet dhe sistemohet material, por brenda segmenteve të nënobjekteve të HEC SETA 1+2, SETA 3 dhe SETA 4.
- Instalimi i tubacionit nën presion kërkon punime për krijim bazamentesh (ankerat e tubacionit) dhe gërmim traseje, materiali i të cilit do të sistemohet në një shesh të paracaktuar.
- Do të ndërtohet godina e agregateve (turbinave) dhe puset e shuarjes së energjisë.
- Do të shtrohet zhavorr dhe do të bëhen punime të ndryshme si mure guri, betoni, dhe risistemime për riformimin e peizazhit, duke e kthyer atë në gjëndjen e mëparshme vizuale etj.

Ndikimi i punimeve për ndërtimin e veprave dhe përmasat e ndërhyrjeve nuk do të jenë të ndjeshme, sepse këto dhera do të sistemohen në mjediset më të afërta për të mbushur çarje dhe rrëshqitje të ndryshme, që mund të kenë ndodhur prej vitesh, ose në brigjet e përroit të

Setës, duke shërbyer si mbrojtje (argjinaturë) kundër erozionit nga ujrato dhe duke zvogëluar pasojat e tij.

8.2 Ndikimi mbi ujërat sipërfaqësore

8.2.1 Ndikimi në regjimin dhe përdorimin e ujërave sipërfaqësore.

Zbatimi i këtij projekti nuk lë shkas për ndotjen e ujërave rrjedhës sipërfaqësore nga ndotës të ndryshëm si karburantet, lëndet helmuese etj. Nuk pritet të ndodhë qoftë dhe ndonjë ndotje indirekte, që mund të rezultojë nga shkarkimet në tokë, e më pas të shpëlahen nga rreshjet, pasi ato nuk do të përdoren gjatë zbatimit të projektit apo rehabilitimit të territorit, ndërsa nga karburantet mund të ketë vetëm ndotje aksidentale nga rrjedhja e mjeteve të punës.

8.2.2 Ndikimi në balancën e ekosistemit dhe prurjet ekologjike

Nuk do të ketë ndryshim të parametrave ekologjike si pasojë e marrjes së një sasive të ujit për t'u shfrytëzuar nga veprat. Ky ndikim nuk do të jetë domethënës në pjesën e përroit, ku do të ndërtohen veprat e marrjes së HEC-eve, pasi hidrocentrali shfrytëzon tepricat e ujit, ndaj dhe sasia e ujit që merret për qëllime të prodhimit të energjisë elektrike nga hidrocentrali nuk do të ndikojë në ekuilibrat ekologjikë të përroit. Ndërsa në pjesët e poshtme të tyre (pellgu ujëmbledhës pas godinës) parametrat do të kalojnë në gjendje më të ekuilibruar natyrore, sepse në përrua do të derdhet i gjithë uji që u përdor për qëllime të prodhimit të energjisë, si ushqimi me burime të tjera me prurje të konsiderueshme të përroit sjell një zvogëlim të ndikimit.

Bilanci biotik nuk do të ketë ndryshime në segmentin e përroit, ku do ndërtohen veprat e marrjes së HEC-eve, po ashtu dhe në rrjedhën e poshtme, që është edhe pjesa më dinamike llojore dhe numerike, rivendoset gjendja normale si pasojë e shtimit të ujit nga degët ushqyese të këtij përroi. Duke qenë se shfrytëzimi i ujërave nga vepra hidroenergjitike në periudha kritike do të jetë i kufizuar, kjo bën të mundur ruajtjen e ekuilibrit ekologjik të pellgut ujëmbledhës. *Kjo vlerë ekologjike e normës ujore është përcaktuar në legjislacionin shqiptar mbi mjedisin.*

8.3 Ndikimi mbi ujërat nëntokësore

Zbatimi i projektit nuk do të ndikojë mbi ujërat nëntokësore pasi kanalet e derivacionit të HEC Seta 1+2 do të ndërtohen prej betoni 1.5m x 1.5m, ndërsa Kanalet e HEC-eve Seta 3 dhe Seta 4 do të ndërtohen me tubacion çeliku përgjatë shtratit të përroit. Kjo metodologji nuk do të ndikojë në rritjen e zgavrave dhe të carave të formacioneve të tokës duke i aksidentuar ato për të ndikuar negativisht në rritjen e filtrimit të ujërave nëntokësore.

8.4 Ndikimi mbi biodiversitetin (Bimët e ujit, Flora, Fauna, Habitatet, Pyjet etj)

8.4.1 Bimët e ujit

Në zonën ku do të merret uji nuk ka bimë uji, për vetë morfologjinë që ka lumi dhe për karakterin abraziv të tij, si në zonën ku do të merret uji po ashtu edhe në zonën ku do të ndërtohen ndërtesat HEC-eve SETA 1+2, SETA 3 dhe SETA 4. Si pasojë, nga ky aktivitet nuk do të ketë dëmtime të tyre dhe rrjedhimisht, as masa mbrojtëse.

8.4.2 Flora dhe fauna

Zona, siç është përshkruar edhe më lart, vetem pjesërisht terreni ku kalon Seta 1+2 është e mbushur me bimesi kurse ndërtimi i Setes 3 dhe Setes 4 do të shfrytëzoj shtratin e perroit i cili pothuaj është i cveshur nga bimesia. Fauna e zonës, sidomos ajo ujore, nuk pëson ndonjë ndryshim të ndjeshëm nga ky projekt pasi do të shfrytëzohet jo e gjithë prurja ujore e lumit. Prurja ekologjike, në kohën më të thatë, do të rrjedhë në shtratin ekzistues të perroit. Pjesa e lumit në rrjedhën e poshtme mbas ndërtimit të HEC SETA 1+2, SETA 3 dhe SETA 4 konsiderohet e mbushur me peshq. Për lëvizjen e peshqve në gjithë gjatësinë e perroit, vepra e marrjes në pjesën e pasme të saj do të projektohet me sistem shkallëzimi ujor.

Aktiviteti i ndërtimit e shfrytëzimit nuk sjell ndikime negative në folenizim, shumëzim etj. Gjatë fazës së shfrytëzimit nuk ka elemente të shqetësimit për dëmtimin e faunës. Do shfrytëzohet deri 85% e prurjes së ujit, ndërsa prurja ekologjike do të jetë 10-15% e prurjeve mesatare.

Hidrocentrali	Ditët	Q _{mes}	Q _{eko}
Seta 1+2	100	2600 l/sek	300 l/sek
Seta 3	100	4500l/sek	500 l/sek
Seta 4	100	6000 l/sek	800 l/sek

Po ashtu edhe fauna karakteristike e zonës është e paprekshme nga ndikimet e ndërtimit të ketyre kanaleve, pritave e tuneleve, për arsye se aktiviteti i ndërtimit dhe shfrytëzimit nuk dëmton, as në lloje e as në numër, elementët e florës dhe faunës, si pjesë përbërëse e këtij rajoni.

Pra, si përfundim theksojmë se ndërtimi i hidrocentraleve SETA 1+2, SETA 3 dhe SETA 4 dhe shfrytëzimi i tyre nuk e dëmton florën dhe faunën e kësaj zone.

8.4.3 Habitatet (objekte me status të cilësuar)

Në zonën e zgjedhur për projektin në fjalë nuk ka habitate apo objekte me status të përcaktuar, por theksojmë se e gjithë zona ku këto nënobjekte do të ndërtohen është zone, e cila nuk ka ndonjë status të veçantë mbrojtjeje.

8.5 Ndikimi mbi manaxhimin e tokës

Sipas kontratës me titull “Kontratë për marrje me qira të tokës pyjore/kullosore” të nënshkruar me Ministrinë e Mjedisit, e gjithë sipërfaqja e përgjithshme e ndërtimit kalon nën manaxhimin e shoqërisë investitore për periudhën 35 vjet të koncesionit.

8.6 Ndikimi mbi peizazhin

Kemi theksuar se karakteristike e HEC SETA 1+2, SETA 3 dhe SETA 4 është ruajtja dhe mos ndryshimi i peizazhit dhe mjedisit turistik të saj, prandaj peizazhi nuk ka për të patur asnjë dëmtim. Për të eliminuar ndonjë impakt të vogël negativ që mund të rezultoj gjatë fazës së ndërtimit do të respektohen me rigorozitet të gjitha detyrat e lëna në VNM dhe Lejet mjedisore për këtë qëllim. Po ashtu edhe arkitektura e objekteve është përshtatur peizazhit ekzistues.

8.7 Ndikimi mbi zhurmat dhe ajrin

Gjatë ndërtimit të HEC SETA 1+2, SETA 3 dhe SETA 4 do të ketë përdorim të makinerive për punime gërmimi, transporti materialesh etj.

Për të zbutur efektin e trafikut të ngarkuar dhe të zhurmave që e shoqërojnë atë, me qëllim uljen e shqetësimeve për popullatën që jeton përreth zonës së ndërtimit të hidrocentralit, si rrugë të përkohshme do të përdoren ku të jetë e mundur rrugët dytësore. Nga projekti janë parashikuar ndërtimi i rrugëve ndihmëse.

Transportimi i materialeve të ndërtimit në rrugët ekzistuese do të programohet me kujdes për të shmangur çdo shqetësim në trafikun lokal. Gjatë natës, automjetet e ndërtimit do t'iu kërkohet, që të lëvizin me shpejtësi të ulta dhe do të ndalohej përdorimi i borive pranë zonave të banuara.

8.8 Ndikimi mbi trashëgiminë kulturore dhe arkeologjinë

Si rezultat i ndërtimit të HEC SETA 1+2, SETA 3 dhe SETA 4 në këtë zonë nuk ka dhe nuk do të ketë ndikime negative mbi trashëgiminë arkitektonike dhe historike, tiparet arkeologjike, si dhe vepra të tjera njerëzore, sepse në zonë dhe rreth saj, nuk ka objekte të një rëndësie të veçantë. Për këtë qëllim është hartuar edhe raporti respektiv edhe janë marrë vendimet nga autoritetet përkatëse:

9. Anekse (Hartat në format A3).

Për HEC Seta 1+2:

- 9.1. Planvendosja e nënobjekteve (ortofoto) dhe Vend grumbullimet i materialeve;
- 9.2 Planimetria dhe prerja tërthore e veprave të marrjes;
- 9.3 Planimetria e godinës së centralit dhe basenit të presionit;

Për HEC Seta 3:

- 9.4 Planvendosja e nënobjekteve (ortofoto);
- 9.5 Planimetria godinës së centralit, veprave të marrjes dhe basenit të presionit;

Për HEC Seta 4:

- 9.6 Planvendosja e nënobjekteve (ortofoto) dhe Vend grumbullimet i materialeve;
- 9.7 Planimetria godinës së centralit, veprave të marrjes dhe basenit të presionit;

